VENDIM
Nr. 13, datë 10.1.2018

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS
PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË ALESIO-2014 SHPK NË AKTIVITETIN
E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC KRYEZI,
ME FUQI TË INSTALUAR 1.99 mw

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike"; neneve 4, pika 1, germa "a"; 5, pika 1, germa "a"; 10, pika 1 dhe 3 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 19, pika 1 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.1.2018, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria Alesio-2014 sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurave për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë Alesio-2014 sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b", "c") është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "e", "f", "g") është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "b", "c") është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 3, germa "d" (vërtetimin e pagesës për aplikim në llogari të ERE-s), do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", t'i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë Alesio-2014 sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Kryezi, me fuqi të instaluar 1.99 mw.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti